
Gjethet bien në pranverë

Dielli i fshihej shkëmbit të shqiponjave, vrunduj erërash të acarta e godisnin pa pushuar nga të gjitha anët. Strukur zgërbonjës së ahut të moçëm, Braho Fordina vështronte kuturu kredhur në pështjellim mendimesh dhe ndjesish të ngatërruara. Kohën e maste me dritë e terr, shpesh i pasigurt në fekste mëngjesi, a binte mbrëmja.

Grabitqarët e ajrit nuk guxonin të dilnin nga guvat. Prijësi dremiste me kokën futur krahëve. Mashkulli më i madh i tufës e mori kreun me luftë. Mbrëmjes, në dritën e argjendtë të hënës, u bë dëshmitar i përlëshjes së egër me sqep e thonj, cërkave të gjakut, pendëve shpërndarë ajrit si gjethe panje në vjeshtë. Dhjetëra shqiponja kacavjerrë pjerrësive të thikta, pastronin pendët, sodisnin shpërfillëse betejën. Goditjen fatale i moshuari e mori në ajër mbi kokën e tij. I riu e ndoqi në tokë, i erdhi rrotull, pa njeriun përfund ahut, u kthye te grigja. I arratisuri fiksoi këmbët e plota si qafa mjellmash, kokën e brymtë, njollën e kuqërremtë krahut të majtë.

- Urime, or mik! - e përgëzoi.

Ai rrotulloi kokën.

Ditët që erdhën u panë disa herë. Shqiponjat ndienin praninë e tij dhe krrokatnin në kor të shqetësuar. Aty kishin vezët, të vegjlit, shtëpinë. Prijësi e sulmoi tekta u orvat të ngjitej shpatit jugor, më pak i pjerrët. Sqepi depërtoi rrëshqanthi shpatullën, copëtoi gunën, i hapi plagë. Arriti në kohë të lëvizte kokën dhe shpëtoi sytë. U tërhoq zgavrës së hapur nga egërsirat, mbylli derën e sajuar me degë të forta shkoze.

Të nesërmen leqet ngritur mjeshtërisht në kryqëzimet e vragave të pyllit zunë lepur të majmë mashkull. Kokën dhe shpatullat i hodhi dy metra përpara derës. Prijësi u shkëput, ndaloi mbi degët e poshtme të ahut, iu hakërrye, u sul, rrëmbeu prenë. Fitorja u përshëndet me klithma shurdhuese. Herën tjetër e la gjahun afër këmbëve. Zogu kërcëu në tokë, u qas krahëhapur me ecje qesharake prej çalamani, shpupuriti krahët i gatshëm të ngrihej në ajër, e mori pa bujën e ditës së parë. Mandej nuk ngurroi ta përlante prenë nga dora e njeriut.

Miqësia me shpendët mori formë kur u strehua në shpellën e stalagmiteve përkrye shkëmbit, i vetmi vend sigurie në qerthullin e malit. Syri i shqiponjave kapte lëvizjet e dyshimta në largësi të mëdha, iu desh fare pak të dallonte ndjekësit nga kafshët e egra që hynin në territorin e tyre. Nga ndjekësit e mbronte shpella në krye të shkrepit, nga egërsirat zgërbonja e ahut përfund.

Dimrit ushqeui koloninë e dobësuar nga të pangrënët me lepuj, dhelpra, thëllëza, ç'zinin kurthet. Darka e shqiponjave nuk ishte shtruar kurrë kaq e bollshme, vizitat e tij pritëshin me krakëllima të buta miqësore. Ditëve me diell miqtë fluturues zhonglonin reve lela e gri në kopshtin zoologjik të qiellit, barisnin shullëreve të shkëmbit, zgjatnin qafat, mprihnin sqepat. Pupilajat e argjendta, krahët ngjyrë çeliku shpërhapnin dritën me gjithfarë nuancash ylberi.

Nga afër vuri re se kishin fytyrë. Të gjitha njëlloj e prapë të ndryshme, i ndërmendën gratë e fshatit veshur me të zeza që turrnin e mbanin nëpër gojë njerëzinë. Ajo e cepit majtas me qafën e bardhë, pupilat e imëta si bashka leshi, ecjen çalthi nga këmba e majtë, i solli të gjallë plakën Mine. Edhe sqepin të kërrusur si hunda e saj. Ja dhe Tina me Ritën mendjelehtë i bënin shenja të turpshme një mashkull shtatmadh që s'ua varte. Gjeti mjaft të njohur mes tyre, iu bë se të dashurit e tij, shndërruar në zogj, kishin ardhur t'i lehtësonin arratinë. Sytë e mendjes shkuan më tej, i sollën natyrën e hareshme të fshatit, puthjen e erës me drurët e pyllit, kundërmimin e athët të eshkës, zukatjen e bletëve gjoksit të shkëmbit.

Kujtimet e sulmuan pa mëshirë...

Vallen dyshe e luajti për herë të parë në dasmën e vëllait me Lanin. Ua mësoi Xha Meti mbrëmjeve, një dimër të tërë.

- Ju shkon, - u tha, - enkas për ju.

Fustanellat, këpucët, takijet, të gjitha borë të bardha e ndezën lëmin, valltarët e rinj nuk kërcenin, po fluturonin. Aty pikasi sytë e lotuar të Shqipes tek ndiqte spërdredhjet e frikshme. I mbeti koka andej. Si nuk e pati vënë re më parë?

Kaq pranë!

U ngrit në këmbë të shkundte përhitjen e kohës...

Vegimet e ditës i kontrollonte disi, ëndrrat natën e sflitnin.

- Përse? - e pyeste vajza e kulluar së qari.

Përgjigja tretej fjalëve të pathëna.

Zgjohej, thërriste, përpiqte pëllëmbët pas faqeve të gurta.

- Përse?! - hungërinte nëpër shpellë.

Sado përpiqej nuk gjente zgjidhje, po thellë vetes regëtinte shpresa, imazh që zhduket e s'kapet dot. Ndoshta do ta shihte edhe një herë. Sa gjëra ndodhin në botë!...

Muaj të tërë shpëtoi në fije të perit nga forcat e ndjekjes. Kur ngushtuan zonën e kërkimit, u detyrua t'i qepet shkëmbit. Prijësi e soditi pa luajtur vendit, kolonia vijoi të merrej me punët e veta, si të mos e vinte re. Sundimtarët e ajrit e pranuan pjesë të tyre njeriun me gunë. Pas përpjekjesh të pabesueshme, zuri shpellën e stalagmiteve. Zor të ngjitej në rrethana të zakonshme.

Streha e re, ku hipte e zbriste sa herë ia donte puna, konsiderohej e paarritshme nga ndjekësit. Ndonëse gjurmët humbnin rrzëzë shkëmbit, nuk besonin të qe kacavjerrë majë tij. Ftohtësira dhe forcat e ndjekjes e bllokuan ditë e net të tëra. Rrethimi i fundit në janar e shtrëngoi të ngjitej. Natën cikna veshi me akuj të pakalueshëm shkallët e pjerrëta prej gurësh të dalë si kukunj, e mbylli në çarkun e lartësisë, pa asnjë lloj ushqimi, veç ujit të dëborës.

Një mbrëmje prijësi qarkoi kthetrat brirëve të akullit në hyrjen e shpellës, lëshoi gjoksin e një dhelpre të vogël kuqalashë. Preu një copë, e përtypi me nxitim. Si i erdhi çehrja, ngriti sytë, e falënderoi përulësisht mikun murrmas për dhuratën e çmuar. Si ta kuptonte gjuhën e tij, e përshëndeti me krrokëritje miqësore.

Skuadra e njerëzve të armatosur nuk vonoi të çatiste si tufë ujqish të uritur. Pasi kontrolluan pyllin me pëllëmbë, pa gjetur kurrfarë shenje, u mblodhën të shestonin planin për më tej. Ndezën zjarr, hëngrën darkë, vunë roje, pritën të gdhinte mbuluar me gozhup të trashë pambuku. E dinin se ndodhej aty rrotull, po tamam nuk e merrnin me mend.

Brahua e kuptoi se kësaj radhe nuk do të largoheshin duarbosh dhe mori nishan, qëllloi në mish. Rënkimi i të plagosurit i vuri në panik. Zunë pozicion, nisën të shtien kuturu. Ngaqë e përjashtonin majën e shkrepit, u rrekën më kot të shkoqisnin kahen e rrezikut. Krismat e tjera i detyruan t'ia mbathnin. Të vvarin e lanë në mëshirë të fatit.

Grigja nuhati erën e gjakut. Më të pushuar krismat, prijësi u krodh fluturimthi, i nxori sytë, pastaj në pak minuta për lanë mishin, lanë kockat të zbardhëllenin në dritën e hënës. Atij i hipën të ngjethura. Provoi të maskohej nën kapelën e të vvarit. Zhurmërima armiqësore e shtrëngoi ta hiqte. Sa herë e sillte rasti, u hidhte kapela, xhaketa, rripa lëkure, gjithçka linin ndjekësit, ndiqte me interes sjelljen. Shqiponjat sulleshin në grup, copëtonin trofetë.

I qeshën sytë, nuk ishte vetëm në orvatjen e çmendur...

Streha përmbi shkëmb ofronte pamje magjike si në përralla. Pylli shtrihej sa hante syri mijëra metra teposhtë ultësirës së Shkumbinit. Ahet vishnin shpatet e brigjeve dhe çukave të thikta, vendet e ulëta i mbështille si pambuk petku i ngjeshur i lajthive, shkozave, dëllinjave mbuluar me borë. Lumi i mbarsur me ujërat e përrenjve përreth, gjarpëronte madhështor në shtratin e zgjeruar.

Në fund të shkurtit atmosfera e pastruar e lejoi të shihnte ndërtesat e thjeshta të fshatit zhytur dëborës si milingona të vogla gri. Kërkoj me mend shtëpinë e tij, arrën e madhe mbi çati, kruan përfund lëmit... sytë iu errën, veshët i buçitën nga ulërimat...

Grumbulluesit e drithit mblodhën burrat në sheshin e manit.

- Ku e keni fshehur bereqetin? - i bërtiti i pari i tyre të atit, sapo zgjedhur kryetar fshati.

- Nuk ka bereqet të fshehur, as të pa fshehur, - ishte përgjigja.

- Kemi informacion, pa erdhëm.

- S'ka se si, fshatarët po vdesin urie.

- Shteti i ri mbahet me detyrimet tuaja.

- E di.

- Atëherë?

- Kur s'ka, s'merr as mortja.

Burri i vjetër, i gjatë si shkop, sikur tallej.

- Ka mënyra të tjera, - hungëroi.

Ngriti supet.

Shkurtabiqi muskolor e nopran pas tij u qas, e goditi me tërë fuqinë nën nofull. Plaku u shemb përdhe. Brahua u lëshua ta ngrinte, po një shkelm i fortë e la pa frymë. Gjaku i vajti në tru, u hodh në këmbë, i nguli thikën në gropën e qafës aq shpejt, sa të tjerët nuk arritën të bënin lëvizjen më të vogël. Tehun e gjakosur ia vuri në fyt të parit.

Sakaq e rrethuan tyta armësh.

- Thuaju t'i hedhin! - i tha sa më qetë mundi.

Ai e pa veten ngushtë, thika i gërvishte qafën, gjuri i djalit shtatmadh si ndonjë ari e torturonte në fund të barkut.

- Bëni si thotë, - mermëriti.

Të dërguarit e qeverisë u larguan, duke lënë pas armët dhe ankthin.

Fshatarët ndalën frymën. Djali u çmend, si do të hahej me qeverinë një fshat i vetmuar!

S'mbahej mend të turpërohej kështu shteti, shumë syresh mendonin se ngriti dorën kundër Zotit.

Brahua flaku thikën, u mbështet pas trungut të manit.

- Bëra atë që duhej, - u orvat t'i qetësonte.

Lani miratoi me kokë, shumica e të rinjve i erdhën pas.

- Kush dëshiron, të vijë me mua, - u tha.

Njëmbëdhjetë djem të moshës së tij, aq sa armët trofe, e ndoqën.

I ati e përqafoi me lot në sy.

- Bir i babait! - mundi t'i thotë, para se të fikej.

Emri i tij u përhap me shpejtësi. Taksat u merrnin frymën, shteti i kërcënonte, shpresat u davaritën në pak vite. Orvatja i gjante shiut verës së thatë.

Revolta ngriti në këmbë qeverinë. Forca të armatosura iu qepën këmba-këmbës. Në përpjekjen e parë u vra i vëllai. Trupin e masakruan faqe njerëzve. Plaku nuk e mbajti hidhërimin, vdiq në mbrëmje. Dhe mori me vete brengën.

Ndjekja në thellësi të pyllit vijoi.

E egër, këmbëngulëse.

Arratia nuk kishte të ardhme, do të përmbysnin gur mbi gur t'i kapnin.

Braho Fordina mblodhi shokët e mbetur.

- Ikni, - u tha, - ju nuk keni faj, më kërkoni mua.

U bindën pa shumë fjalë, po ndëshkimet i morën të rënda.

Shteti nuk i falte rebelët.

U end i vetmuar si lugat labirinteve të pyllit. Ku ngrysej s'gldhihej. Frymën e mbante me vezë shpendësh, mish gjahu, kërpudha. Ushqime i sillnin rrallë. Nuk ishte e lehtë të ndihmoje hasmin e qeverisë.

Spiunët përgjonin...

Ndriçimi zvetënues i diellit të padukshëm, rrinte ende varur. Kur u shua e fundmja regëtimë drite, qielli erdh u bë jargavan e blu, terrina pushtoi vendin. Para se ta zinte gjumi, e bëri zakon të fliste me prijësin. Thurte plane, më së shumti ëndrra në diell, i prishte, kërkonte mendimin e aleatit fluturues.

- Eh, or mik, si do të vejë filli?

Ai nuk u ndje, si të respektonte monologun e tij.

- Nuk je si ata, - bëri me dorë andej nga duhet të qenë ndjekësit.

- Krra, krra, - zgjati kokën, mprehu sqepin në cep të guvës.

- S'i thonë shaka, luftë me shtetin, - u mburr.

Prijësi i shqiponjave futi kokën mes krahëve.

Sa gjumash je?! - e përqeshi.

Natën bëri gjumë të trazuar ëndrrash.

Dita hapi udhë përmes të çarave të qiellit, shkëmbi shndriti në të kuq të bakërt, thua mori flakë nga të brendshmet e tij. U shtriq, lau duar e fytyrë me dëborë, mbajti hapin te vendi i vet i vëzhgimit. Sytë i zunë lëvizje të pazakonta rrugëve të fshatit, flakë stërmëdha shpërthyen në sheshin ku lartohet mani. Zjarre ndiznin pranverës, pastronin arat për mbjelljet e reja, po dimrit kurrë. E pa veten fëmijë tek grumbullonte ferra, rrënjë barishtesh të egra, degë të thata, kuskuta misri. Dhjetë muaj mes egërsirave, larg shtëpisë, të afërmve, pa zëra njerëzish, ia ngatërruan kohërat, zemra nuk duroi.

E priste, madje u vonuan.

Uli kokoren, flaku gunën, futi thonjtë nëpër gurë, gjakosi duart, rrëshqiti, u ngrit pas hejeve të akullit. Zoti e shpëtoi nga rrokullima në humnerë.

Rrugës takoi Lanin që dihaste.

- Kërkoni strehën tënde, - i tha me ndërprerje zëri.

Hoqi armën nga supi, shtiu pa iu dridhur dora, aq shpejt sa tjetri e pati të mundur ta ndalonte. Shigjeta të zjarra çanë qiellin e fshatit...

Gjyqi erdhi shpejt.

U përpoqën të zbulonin lidhjet me armiqtë, fijet e komplotit, bashkëpunëtorët. Nuk besuan arratinë e vetmuar.

- Me se ushqeheshe? - e pyetën.

- Mish gjahu.

- Dimrit?

- Vija leqe, e bëjmë gjithnjë në fshat.

- Ku strehoheshe?

- Në shkëmbin e shqiponjave.

Dërguan njerëz, e panë. Ngruhina shkëmbore e thiktë u ngjethi mishtë.

- Atje nuk ngjitet njeriu, - i thanë.

- Unë u ngjita.

Këmbëngulja i nervozoi. Mos priste ky buzëqumësht ta besonin?!

Akuza për rrëzimin me dhunë të qeverisë e çuditi.

- Me qeverinë nuk pata punë, - u tha.

- Vrave grumbulluesin e drithit, preke shtetin.

- Shteti nuk i djeg njerëzit e tij, - u inatos.

Dhe heshti.

Tërë ato pyetje pa kuptim!

Gjyqi e dënoi me varje publike...

Pranvera e atij viti s'u ngjante të mëparshmeve, erdhi disi e vonuar. Kumbullat sapo mugulluan, arrat dimëronin ende. Era e malit ngjishte ca re gri ngarkuar me lagështirë, çast pas çasti firote dritën e diellit.

Në sheshin e ekzekutimit zvarritën banorët e pesëdhjetë fshatrave. Të tijtë erdhën vetë. Donin ta shihnin edhe njëherë. Shumica qanin fshehur, thua turpëroheshin prej lotëve. Një çupë e re fshinte sytë e buhavitur, të ëmën plakë e mbanin për krahu.

Aq njerëz bashkë, Brahua nuk kishte parë ndonjëherë.

"Janë mbledhur për mua!" - u rrëqeth.

Ishte dhe s'ishte mes tyre, kaq shumë gjëra të thjeshta jetësore do të zhdukeshin.

Mposhti plogështinë që po e mpinte, fërkoj kyçet e duarve, ngriti sytë të merrte sa më shumë imazhe. Në cep të opingës një gjethe e tharë kumbulle fërfëllinte. Druante mos shkolitej e binte, po fletëza e gjorë qëndroi me kokëfortësi.

Gjindja mbajti frymën.

Në qetësinë e përmortshme u dëgjua një zë i thatë si tingull teneqeje.

- Çfarë ke për të thënë?

U habit si fëmijë. Çfarë priste të thoshte? Se jeta e tij sapo kishte nisur, se në shesh një vajzë e priste, se nuk donte të vdiste aq i ri? Kush nuk i dinte këto!

Çoi dorën, vuri rregull flokëve, shprishur nga thëllimi.

- Lanin, - tha, - dua Lanin.

Zbatuesi i ligjit s'e kuptoi, u mat të kërkonte sqarim, kur vuri re të riun me çantë në dorë të shkëputej nga turma.

"Ky qenka tjetri," - u vrenjt.

Lani nxori fustanellat, kapat, këpucët, të gjitha të bardha. Nga mesi i turmës u qas një plak thatanik me gajde nën sqetull, pas tij dy burra jo aq të rinj me fizarmonikë e daulle.

Xha Meti e puthi me dorë, lëshoi tingujt e gajdes. Të tjerët e ndoqën. Në mes të sheshit buçiti melodia e njohur.

Braho Fordina i përkëdheli me sy, si t'i falënderonte me gjithë shpirt, ngriti këmbën e djathtë, u mbështet mbi supin e shokut, nisi këngën.

"Plot molla lule të bardha..."

Lani e ndoqi me zë të dridhur nga mallëngjimi.

"... Hej, lule të bardha..."

Kërceu mbi kokën e tij, ra me njëren këmbë të përkulur. Gjuri preku tokën, trupi kaba u përdrodh si pupël.

- *Dil i mblidh moj çupë e re*, - oshtiu zëri nën hijen e litarit që lëkundej me pulsën e valles.

- *Unë i mbledh po s'kam në se*, - pritësi mbante ritmin.

U dëgjua një *oh* e zgjatur vajze.

E vështroi vëngër nga ajri, si ta qortonte për dobësinë, u hodh përpara...

Qindra njerëz ndiqnin sy e veshë magjinë e Braho Fordinës, kapedanit të valles. E kishin parë të luhej nëpër dasma, fejesa, lindje, po kështu kurrë. Gratë s'u fshehën më, dënesnin me zë të lartë, vajzës së fikur i hidhnin ujë.

Një zë i dridhur plake u ngrit mbi të gjithë.

"Jam zgjuar apo në ëndërr oi, oi,

Bir të bëri nëna dhëndër oi, oi..."

Me njëren dorë dridhte shaminë e kokës, me tjetrën shkulte leshrat e hirta.

- *Të marton nëna me litarin, o bir!*

- U çmend, - tha dikush.

Dhjetëra sy e panë me inat.

- Jepini fund, - urdhëroi zbatuesi i ligjit.

Zëri iu mpak.

I dënuari shkoi në litar i lehtësuar si besimtarët që rrëfelen para vdekjes.

Nga arra në qosh të sheshit u sul vërtik një shqiponjë. Njerëzit panë të fluturonte nga dërrasat e trekëmbëshit xhelatin pa sy, në vend të tyre dy gropa të kuqe. Zogun e metaltë me sqepin e kthyer dhe njollën e kuqërremtë kraut të majtë, e vunë re të largohej me shpejtësinë e plumbit vetëm disa.

Më pas nuk ishin të sigurt.

Braho Fordina e pikasi prijësin përpara se të kridhej në degët e arrës. Ia njohu krakëllimën.
